ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Keshilli Prokurorial i Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **250-25-2745-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Dezinfektim,Dezinsektim dhe Deratizim të hapsirave të objekteve të sistemit prokurorial të Kosovës**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**D D D SH.P.K.**
NUI	**811319955**
Adresa	**rr. Ahmet Krasniqi, obj.Vicianum K-3, ARBERI**
Vendi	**Prishtine**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**048/166909**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Shaip Berisha**
Adresa elektronike	**nshp.ddd@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**01.05.2025**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Dezinfektim,Dezinsektim dhe Deratizim të hapsirave të objekteve të sistemit prokurorial të Kosovës

Operatori Ekonomik "DDD SH.P.K." ka dorëzuar kërkesë për rishqyrtim më datë 19.04.2025, lidhur me përmbajtjen e dosjes së tenderit dhe specifikimeve teknike të cilat bien ndesh me parimet e konkurrencës së drejtë dhe barazisë në trajtim. Më datë 23.04.2025, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën tonë me një vendim të pabazuar dhe të paarsyetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë.

Ky aktivitet i prokurimit publik ka qene ne apel deri me daten 28.04.2025 ku AK ka bere korigjimin e Dosjes se tenderit pa ndonje ndryshim ne kerkesat e tyre.

Bazuar ne kete ne mendojme se jane shkelur dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik:

- Neni 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti

- Neni 7 – Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi

- Neni 9 – Përcaktimi i nevojave

- Neni 28 – Specifikimet teknike

- Neni 59 – Kriteret për kapacitetin teknik dhe professional

Si pasojë, ne parashtrojmë këtë ankesë në OSHP.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo ☐**

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Arsyetimi i detajuar i ankesës

1. Kriteri diskriminues për menaxherin e projektit

AK ka kërkuar që menaxheri i projektit të jetë "Bachelor i Kimisë Inxhinierike", çka përjashton ekspertët e kualifikuar në fushën DDD si epidemiologët, ekologët, agronomët dhe veterinarët — të cilët sipas nenit 59 të LPP-së dhe praktikës së dhënë në vendimin e OSHP-së nr. 283/22 të datës 03.10.2022, janë profesionistët përkatës për këtë lloj kontrate si dhe kerkesave te MBPZHR per profesioniste të cilët janë edhe të kërkuar ligjërisht për marrjen e licencës/lejes se perkoheshme per kryerje te sherbimeve te DDD nga MBPZHR.

Kjo kërkesë përbën shkelje të nenit 7 (barazia në trajtim) dhe nenit 28 (specifikimet teknike), duke kufizuar konkurrencën dhe duke mos reflektuar realitetin profesional të sektorit DDD.

2. ISO-t e kërkuara janë të paqarta dhe jo në përputhje me objektin e kontratës

Është kërkuar që OE të ofrojë ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015 për shërbime të HIGJIENES, ndërkohë që kontrata ka të bëjë me shërbime te Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit dhe JO PER HIGJIENE/PASTRIM. Kjo përbën shkelje të nenit 6 (efikasiteti dhe ekonomikiteti) dhe nenit 28, sepse vendos një kusht të panevojshëm dhe jo përkatës që nuk pasqyron natyrën e kontratës.

3. Mungesa e kërkesave për pajisje për dezinsektim hapësinor te jashtem sipas kerkeses ne Aneksin 1 te dosjes se tenderit si dhe mungesa e paramases ne dokumentin Pershkrimi i cmimeve.

Në dosjen e tenderit tek Lista e paisjeve dhe mjeteve tjera të nevojshme që duhet ti posedoj operatori ekonomi për realizimin e kontratës nuk është kërkuar asnjë pajisje profesionale si ULV gjenerator elektrik/termik apo fogger i montuar në automjet apo mjete të tjera që janë thelbësore për realizimin e këtij shërbimi. Dezinsektimi hapësinor I jashtem nuk mund të realizohet me pompa të thjeshta apo metoda manual pasi qe ky sherbim kërkon mjete që krijojnë grimca të imëta aerosoli, të cilat qëndrojnë në ajër dhe mbulojnë zona të gjera me saktësi, sipas standardeve të WHO dhe EPA. Asnjë prej këtyre pajisjeve nuk është e përshtatshme për dezinsektim hapësinor profesional.

Ne pergjigjen e AK dhe arsyetimi I AK se paisjet / pompat te cilat I kane kerkuar jane ULV mirepo, ne dosje te tenderit tek Lista e paisjeve dhe mjeteve tjera të nevojshme që duhet ti posedoj operatori ekonomi për realizimin e kontratës nuk

eshte precizuar apo korigjuar edhe pse AK me daten 28.04.2025 ka bere korigjimin e dosjes se tenderit.

Po ashtu sipas njohurive tona deri me tani AK-Keshilli Prokurorial I Kosoves nuk ka pasur asnjeher ndonje aktivitet te prokurimit publik per kryerje te sherbimeve te Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit dhe Dezinsektimit hapsinor te jashtem dhe ku e njejta ne pergjigjen ndaj kerkeses sone per rishqyrtim paraqet se kane pasur nje sherbim te tillet ne te kaluaren, gje qe eshte e pa vertet. Cdo here bazohemi ne aktivitetet e prokurimit publik te cilat jane te shpallura ne e-prokurim.

Po ashtu AK ka kerkuar ne Aneksin 1. qe te kryhet sherbimi I Dezinsektimi hapësinor te jashtem mirepo I njejti nuk ka bere asnje korigjim ne dokumentin Pershkrimi I cmimit, pra kane kerkuar sherbim mirepo, nuk kane vendosur pozicionin-paramasen per sasin e hapsirave te jashteme (meter katrore, ari apo hektar !!!) te cilat duhet te trajtohen/dezinsektohen dhe njeherit nuk ka pozicion per vendosje te cmimit edhe pse kane treguar ne pergjigje se jane hapsira te vogla te njejtat duhet te jene te precizuara!!!

I njejti informacion mungon dhe tek Aneksi 1. I dosjes se tenderit.

Mosvendosja e paramasës për sipërfaqe është shkelje e nenit 9 (përcaktimi i nevojave) dhe krijon paqartësi që cënon përgatitjen e një oferte konkurruese dhe të saktë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Bazuar në analizën e dokumentacionit të tenderit dhe kerkeses sone per rishqyrtim vlerësojmë se janë shkelur dispozitat e mëposhtme të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Nr. 05/L-092:

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe efikasiteti
Neni 7 - Barazia në trajtim dhe mosdiskriminimi
Neni 9 - Përcaktimi i nevojave të arsyeshme
Neni 28 - Specifikimet teknike dhe përjashtimi i alternativave të barasvlershme
Neni 59 - Kriteret për kapacitetin teknik dhe professional

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Kriteri diskriminues për menaxherin e projektit

Në fushën e DDD, ekspertët relevantë janë: epidemiologët, veterinarët, ekologët, agronomet, të cilët janë edhe të kërkuar ligjërisht për marrjen e licencës/lejes se perkoheshme per kryerje te sherbimeve te DDD nga MBPZHR.
Ju lutem referojuni vendimit te OSHP me nr.283/22 te dates 03.10.2022, te bashkangjitur I cili trajton dhe sqaron se cilet duhet te jene profesionistet adekuat per mbikqyrje/kryerje te sherbimeve te DDD.

AK ka kërkuar që menaxheri i projektit të jetë "Bachelor i Kimisë Inxhinierike", çka përjashton ekspertët e kualifikuar në fushën DDD si epidemiologët, ekologët, agronomët dhe veterinarët — të cilët sipas nenit 59 të LPP-së dhe praktikës së dhënë në vendimin e OSHP-së nr. 283/22 të datës 03.10.2022, janë profesionistët përkatës për këtë lloj kontrate si dhe kerkesave te MBPZHR per profesioniste të cilët janë edhe të kërkuar ligjërisht për marrjen e licencës/lejes se perkoheshme per kryerje te sherbimeve te DDD nga MBPZHR. Kjo kërkesë përbën shkelje të nenit 7 (barazia në trajtim) dhe nenit 28 (specifikimet teknike), duke kufizuar konkurrencën dhe duke mos reflektuar realitetin profesional të sektorit DDD.

2. ISO-t e kërkuara janë të paqarta dhe jo në përputhje me objektin e kontratës

Është kërkuar që OE të ofrojë ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015 për shërbime të HIGJIENES, ndërkohë që kontrata ka të bëjë me shërbime te Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit dhe JO PER HIGJIENE/PASTRIM. Kjo përbën shkelje të nenit 6 (efikasiteti dhe ekonomikiteti) dhe nenit 28, sepse vendos një kusht të panevojshëm dhe jo përkatës që nuk pasqyron natyrën e kontratës.

3. Mungesa e kërkesave për pajisje për dezinsektim hapësinor te jashtem sipas kerkeses ne Aneksin 1 te dosjes se tenderit si dhe mungesa e paramases ne dokumentin Pershkrimi i cmimeve.

Në dosjen e tenderit tek Lista e paisjeve dhe mjeteve tjera të nevojshme që duhet ti

posedoj operatori ekonomi për realizimin e kontratës nuk është kërkuar asnjë pajisje profesionale si ULV gjenerator elektrik/termik apo fogger i montuar në automjet apo mjete të tjera që janë thelbësore për realizimin e këtij shërbimi. Dezinsektimi hapësinor I jashtem nuk mund të realizohet me pompa të thjeshta apo metoda manual pasi qe ky sherbim kërkon mjete që krijojnë grimca të imëta aerosoli, të cilat qëndrojnë në ajër dhe mbulojnë zona të gjera me saktësi, sipas standardeve të WHO dhe EPA. Asnjë prej këtyre pajisjeve nuk është e përshtatshme për dezinsektim hapësinor profesional.
Ne pergjigjen e AK dhe arsyetimi I AK se paisjet / pompat te cilat I kane kerkuar jane ULV mirepo, ne dosje te tenderit tek Lista e paisjeve dhe mjeteve tjera të nevojshme që duhet ti posedoj operatori ekonomi për realizimin e kontratës nuk eshte precizuar apo korigjuar edhe pse AK me daten 28.04.2025 ka bere korigjimin e dosjes se tenderit.
Po ashtu sipas njohurive tona deri me tani AK-Keshilli Prokurorial I Kosoves nuk ka pasur asnjeher ndonje aktivitet te prokurimit publik per kryerje te sherbimeve te Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit dhe Dezinsektimit hapsinor te jashtem dhe ku e njejta ne pergjigjen ndaj kerkeses sone per rishqyrtim paraqet se kane pasur nje sherbim te tillet ne te kaluaren, gje qe eshte e pa vertet. Cdo here bazohemi ne aktivitetet e prokurimit publik te cilat jane te shpallura ne e-prokurim.
Po ashtu AK ka kerkuar ne Aneksin 1. qe te kryhet sherbimi I Dezinsektimi hapësinor te jashtem mirepo I njejti nuk ka bere asnje korigjim ne dokumentin Pershkrimi I cmimit, pra kane kerkuar sherbim mirepo, nuk kane vendosur pozicionin-paramasen per sasin e hapsirave te jashteme (meter katrore, ari apo hektar !!!) te cilat duhet te trajtohen/dezinsektohen dhe njeherit nuk ka pozicion per vendosje te cmimit edhe pse kane treguar ne pergjigje se jane hapsira te vogla te njejtat duhet te jene te precizuara!!!
I njejti informacion mungon dhe tek Aneksi 1. I dosjes se tenderit.
Mosvendosja e paramasës për sipërfaqe është shkelje e nenit 9 (përcaktimi i nevojave) dhe krijon paqartësi që cënon përgatitjen e një oferte konkurruese dhe të saktë.

Kërkesat tona për OSHP

- Të konstatojë se vendimi i AK është i pabazuar dhe joligjor.
- Të urdhërojë ndryshimin dhe korrigjimin e kritereve diskriminuese.
- Të urdhërojë përfshirjen e pajisjeve për dezinsektim hapësinor te jashtem.
- Te vendos paramasen tek pershkrimi I cmimit per Dezinsektim hapsinor te jashtem.
- Të pezullojë aktivitetin e prokurimit sipas nenit 112 të LPP-së.
- Të garantohet trajtim i barabartë për të gjithë operatorët.

Dokumentacioni i bashkangjitur:

- Njoftimi per kontrate e dates 03.04.2025
- Kërkesa për rishqyrtim e dates 19.04.2025.
- Vendimi i AK për Refuzim, e dates 23.04.2025
- Dosja e tenderit përkatëse e korigjuar e dates 28.04.2025
- NJoftimi mbi korigjimin e dosjes se tenderit 28.04.2025
- Vendimi I OSHP me nr.283/22 te dates 03.10.2022

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kriteret dhe specifikimet e vendosura në dokumentacionin e tenderit, të formuluara në mënyrë të ngushtë dhe teknikisht të papërshtatshme, krijojnë rrethana që mund të çojnë në përjashtim të padrejtë të operatorëve ekonomikë me kapacitete të plota teknike dhe profesionale për ofrimin e shërbimeve të kërkuara.

Mungesa e pajisjeve të domosdoshme për dezinsektim hapsinor te jashtem në specifikimet teknike, mungesa e paramases ne Aneksin 1 si dhe mungesa e paramases ne dokumentin Pershkrimi i cmimit, si dhe kufizimi i panevojshëm i kualifikimeve të stafit drejt një profili të vetëm, cenon seriozitetin dhe korrektësinë e vlerësimit, duke e bërë procesin të pambështetur në standarde të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit dhe do te behet nje shkelje serioze ligjore nga ana e AK.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*